



ÇFARË NUK ËSHTË THËNË
PËR NAMAZIN?



“DO TË JENI
SI SHKUMA E DETIT!”



PËRSE E FALSIFIKOJNË
HISTORINË?

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 23 - Nr. 1 (263), Janar, 2025

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Nata e Israsë dhe Miraxhit, kurora e mrekullive, me të cilat u dërgua Hz. Muhammedi (a.s).



XHAMIA E KUPOLËS SË SHKËMBIT NË KUDSIN SHERIFË

MUAJ TË BEGATË
DHE ME ADHURIME E LUTJE
TË PRANUARA!

MYFTIU SYTARI: “RUAJENI HAKUN
E KOMSHIUT, DËSHMOJENI DRITËN
E ISLAMIT!”

MBAHET KONFERENCA E 13-TË VJETORE
E IMAMËVE: “ISLAMI, FË UNIVERSALE,
NË SHËRBIM TË NJERIUT!”

MYFTIU I SHKODRËS VIZITON
REKTORIN E UNIVERSITETIT
TË SHKODRËS

“UDHËTIMI QË NDRYSHOI BOTËN”,
BASHKËBISEDIM ME RASTIN E NATËS
SË ISRASË DHE MIRAXHIT

ZHVILLOHET MBLEDHJA
E RAPORTIT TË PËRGJITHSHËM
PËR AKTIVITETIN E VITIT 2024



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të dashur dhe të shtrenjtë, tashmë që jemi në ditët e fundit të muajit Rexheb dhe natyrshëm në hatrin e gjithsecilit prej nesh vjen ajo ngjarje e madhërueshme dhe ajo mrekulli prej mrekullive më të veçanta të jetës së Pejgamberit tonë (a.s.), Israja dhe Miraxhi, për të cilën Allahu i Madhëruar na tregon në dy vende, në dy sure të ndryshme në Kur'anin Famëlartë: në suren e Isra-së dhe në suren e Yllit, suretu-Nexhm.

Mirëpo, teksa flasim për Isranë dhe Miraxhin, apo na vjen në hatër kjo mrekulli e jashtëzakonshme, patjetër që duhet të ndalemi tek një ndër detajet më kryesore dhe ndër mrekullitë dhe mirësitë e begatitë më të mëdha të asaj Nate të jashtëzakonshme: obligimi i faljes së namazit, pra obligimi i namazit për besimtarët muslimanë, nga ajo ditë e deri në ditën e fundit të jetës mbi faqen e dheut, 5 namazet ditore!

Në fakt, kemi folur për namazin e do të flitet për të, sepse është shtylla kryesore e fesë islame, mirëpo kam vendosur që të mbledh disa argumente dhe t'i vendos përpara duarve tuaja për të thënë çfarë nuk është thënë akoma për namazin. Dhe ju do të habiteni! Dikush do të thotë: çfarë nuk është thënë akoma? Përherë ka gjëra të cilat ne i themi, por ka edhe shumë e shumë gjëra të tjera të cilat i zbulojmë gjatë leximeve dhe thellimeve në studimet rreth detajeve të ndryshme të fesë, në këtë rast rreth namazit.

Po lexoja dhe gjeta një thënie shumë të madhe të Hz. Abdullah ibn Mesudit, dijetari i madh edhe fakihu i shquar i sahabëve, që thoshte: **“Atë njeri që nuk e urdhëron namazi i tij drejt veprimit të mirësive dhe nuk e ndalon nga veprimi i të këqijave në jetën e përditshme, ai namaz në fakt nuk i shton këtij njeriu, veçse largim nga Allahu!”** Pra, na thotë

ÇFARË NUK ËSHTË THËNË PËR NAMAZIN?

kujdes të mos jetë namazi juaj lëvizje të pakuptimta ose adhurim folkorik!?

Ka një thënie shumë të madhe të sahabiut të dashur Hz. Muadh ibn Xhebel, i cili i drejtohet djalit të tij duke i thënë: **“O biri im, kur ta falësh namazin, falu si të ishte namazi jot i fundit dhe mos mendo asnjëherë se do të kthehesh më tek ai namaz!”** Si e si për ta nxitur, për t'i dhënë rëndësi çdo namazi!

Pyetja është, a jemi ne korrekt me namazin tonë, a e shijojmë ne çdo dalje ditore përpara duarve të Allahut të Madhëruar? Mendoni për pak, ju fton presidenti, ju fton kryeministri, ose keni pritje, ju vjen një personalitet i shquar për vizitë. Ju jeni në alarm për ta pritur sa më mirë, ose jeni në alarm për të shkuar sa më mirë takimi, për të qënë sa më korrekt, për të respektuar orarin, etj.

Subhanallah, ke 5 herë në ditë thirrje nga Zoti i Gjithësisë për të prezantuar para duarve të Tij, a do dalësh i kërpitur përpara Zotit tënd apo edhe shkeleshko, i pakrehur, i paparfumosur, mbi të gjitha me zemrën e hutuar, mendjen tek ndeshja e futbollit, mendjen tek seriali, mendjen tek kjo tek ajo, tek interesi i kësaj bote.?!?

Kur Hz. Omeri (r.a) u shtri në shtratin e vdekjes, pasi i kishin bërë një atentat pas shpine dhe e kishin goditur për vdekje, ai pothuajse e humbi vetëdijen e tij. Dikush tha: “Nëse doni ta sillni në vete dhe doni ta kuptoni nëse është gjallë apo më afër vdekjes, përmendini namazin sepse ka qenë shumë korrekt me namazin”. Dikush i tha: “O prijësi i besimtarëve, namazi, namazi! Pra çohu se erdhi koha e namazit” Thotë: Ai i hapit syt dhe tha: “Namazi!” Dhe u ngrit për t'u falur dhe vijoi: “Nuk ka hise në Islam ai që e lë namazin!” dhe u ngrit dhe u fal ashtu me plagët që i rridhnin gjak derisa ndërroi jetë. Nuk ka hise në Islam ai që lë namazin! Pejgamberi (a.s) na thotë që dallimi ndërmyjet nesh dhe atyre, pra jobesimtarëve, është namazi!

Prandaj të dashur dhe të shtrenjtë,

Mos ta neglizhojmë namazin, mos ta lëmë namazin për diçka duke thënë do ta kryej më vonë, mos ta lëmë namazin duke thënë: nuk ka ardhur koha akoma, ose nuk ma ka bërë Zoti rizik! Mos të rëndojmë pozitat tona në marrëdhënien me Allahun e Madhëruar! Na është hapur dera e Zotit të Gjithësisë për ta adhuruar

dhe për të dalë përpara duarëve të Tij në një marrëdhënie të mrekullueshme ditore, 5 herë në ditë. Abuzojmë, e lëmë pas dore, e neglizhojmë? Zoti na faltë!

Për fund, një ngjarje shumë interesante në kohën e Hz. Ali ibn Talib, i cili doli në xhami. Ishte Ramazan, ishte nata e parë e Ramazanit, njerëzit ishin mbledhur në xhami dhe ishin ndezur kandilat, ndërkohë libri i Allahut lexohej në xhami. Tha: “Allahu ta ndriçoftë varrin tënd, o Omer i biri i Hatabit, siç i ndriçove xhamitë tona me Librin e Allahut!”, pra kishte për qëllim namazin e teravisë 20 rekate, që është *konsesus i plotë i sahabëve të Pejgamberit (a.s)*, nga momenti kur Hz. Omeri i mbledhi të gjithë së bashku për ta falur teravinë 20 rekate, por edhe më shumë, siç i kanë shtuar dijetarët edhe ulematë ndër shekuj.

MIRËPO, TEKSA FLASIM PËR ISRANË DHE MIRAXHIN, APO NA VJEN NË HATËR KJO MREKULLI E JASHTËZAKONSHME, PATJETËR QË DUHET TË NDALEMI TEK NJË NËR DETAJET MË KRYESORE DHE NËR MREKULLITË DHE MIRËSITË E BEGATITË MË TË MËDHA TË ASAJ NATE TË JASHTËZAKONSHME: OBLIQIMI I FALJES SË NAMAZIT, PRA OBLIQIMI I NAMAZIT ...

Prandaj, të dashur dhe të shtrenjtë, mos ta ngelizhojmë namazin!

Çdo ditë thirrmi: “Hajje ales-salah, hajje alel-felah!”

Çdo ditë ftohemi 5 herë në ditë: “Hajdeni në namaz, hajdeni në shpëtim!”


Allahu i Madhëruar e di më së miri se ky namaz është shpëtim. Ne jemi të mbytur në problematika të shumta të jetës sonë, ku ta gjejmë shpëtimin? Në namaz, para duarve të Allahut!

MUAJ TË BEGATË DHE ME ADHURIME E LUTJE TË PRANUARA!

Me rastin e fillimit të Tre Muajve të Mirë: Rexheb, Shaban dhe Ramazan 1446/2025, Myftinia Shkodër uron të gjithë besimtarët: Muaj të begatë dhe me adhurime e lutje të pranuar!

Nesër, e mërkurë, më 1 janar 2025 është dita e parë e muajit të shenjtë Rexheb 1446, që sinjalizon edhe fillimin e Tre Muajve të Mirë, Rexheb, Shaban dhe Ramazan.

Duke u nisur nga hadithi i Pejgamberit (a.s), i cili ka thënë: “Punoni mirë gjithë kohën dhe shfrytëzoni disa momente të veçanta të mëshirës së Allahut, sepse Allahu i ka caktuar disa momente të veçanta prej mëshirës së Tij, me të cilat i godet atë që dëshiron prej robërve të Tij”. – (Transmeton Tabaraniu)



Për çdo besimtarë, del detyrë që ta presin këtë mirësi të Zotit të Madhëruar me istigfare (kërkim falje), sadeka, lutje dhe të jetë sa më korrekt me veten, me të tjerët dhe veçanërisht me Krijuesin, Allahun e Madhëruar.

Atmosfera e Tre Muajve të Mirë është mundësi e madhe për secilin prej nesh, të rregullojë dhe të përmirësojë marrëdhënien me Zotin e gjithësisë, shtimin e dhikreve, agjëtimeve nafle, sadekasë, përkrahjen e nevojtarëve, etj.

Duhet pasur parasysh, se kjo periudhë, është një mundësi e mrekullueshme për rregullimin e marrëdhënieve familjare, farefisnore

dhe ato shoqërore, duke falur e toleruar njëri-tjetrin!

Përpara se të shpallej Islami, në Muajt e Shenjtë, prej të cilëve është edhe muaji Rexheb, idhujtarët ndalonin edhe luftërat në mes vete. Koha është që besimtarët në këtë periudhë të kontrollojnë se çfarë flasin, të ndalojnë të keqen në mes tyre, të distancohen nga përgojimi e thashethemet, të rregullojnë njetin e të pastrojnë zemrën nga sëmundjet e saj.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: “Numri i muajve tek Allahu është dymbëdhjetë muaj, në librin e Allahut, që ditën që krijoi qiejt dhe tokën; prej tyre, katër janë të shenjtë. Kjo është feja e drejtë, prandaj mos i bëni zullum (padrejtësi) në to vetes tuaj...”. – (Kur'ani, Et-Teube: 36)

Allahu i Madhëruar ka dalluar disa vende, ndaj disa të tjerëve, ka dalluar disa njerëz ndaj disa të tjerëve, dhe ka dalluar disa momente, ndaj disa momenteve të tjera.

P.sh, Allahu i Madhëruar betohet:

– “Betohem për këtë vend..”

Ose është betuar:

– “Pasha jetën tënde...!”

Ose:

– “Pasha kohën!...” etj.

Prandaj, të gjithë ne të jemi të vëmendshëm, veçanërisht gjatë këtyre Muajve të Mirë dhe të mos e shpërdorojmë kohë në gjëra të kota dhe të pavlera.

Gjatë muajit Rexheb, janë edhe disa ngjarje me rëndësi të mëdha historike, që kanë ndodhur në të:

Beteja e Tebukut

Çlirimi i Kudsit Sherif nga Salahudin Ejubi (1187/583h)

Israja dhe Miraxhi

Etj.



REXHEP TAJIP ERDOĞAN
PRESIDENT I TURKIJES

“
NE JEMI NË HALLKËN
NE FUNDIT TË
THYERJES SË LOJËS
IMPERIALISTE, E CILA
I KA SHKAKTUAR DHIMBJE
KËTIJ YMETI, PËR QATI
NJË QJYSMË SHEKULLI!

* * *

KUSH PËRÇAN MES
KURDËVE DHE
TURQVE ËSHTË ARMIK
I TË DYVE, NJËSOJ,
DHE MË KRYESORJA E TËRË
KËSAJ, AI ËSHTË ARMIK
I MUSLIMANËVE!



“ÇFARË NUK KENI DITUR PËR KATËR MUAJT E SHENJTË!”

Në kuadër të ligjëratave me rastin e Katër Muajve të Shenjtë (Dhul-Kade, Dhul-Hixhe, Muharrem dhe Rexheb), dhe në atmosferën e begatë të prag muajit Ramazan 1446 hixhri, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari nisi të xhumanë, më 10 janar 2025, një cikël ligjëratash kushtuar mirësisë dhe begatëve me të cilat është rrethuar kjo periudhë e begatë e vitit hënor.

Nga kursia e xhamisë së Parrucës, Myftiu i Shkodrës iu drejtua besimtarëve me mesazhe që lidhen me mirësinë dhe begatinë e madhe që ka periudha e Katër Muajve të Shenjtë. Ndër të tjera, ai theksoi se: “Në Kur’anin Famëlartë, në suren Et-Teube: 36, përmendet një detaj shumë interesant, që lidhet me shenjtërinë e katër muajve, prej dymbëdhjetë muajve të vitit.

Në hadithe të ndryshme, mësojmë

se këta katër Muaj, janë: Dhulkade, Dhulhixhe, Muharrem, që vijnë njëri pas tjetrit, si dhe muaji Rexheb, mes Xhumadas dhe Shabanit.

Mufesirë të ndryshëm e të shumtë të Kur’anit Famëlartë, duke nisur nga sahabiu, Hz. Abdullah Ibn Abbas (Allahu qoftë i kënaqur me të), e duke vazhduar deri në ditët e sotme, kanë shpjeguar domethënien e ajetit të Katër Muajve të Shenjtë, si dhe veçoritë e kësaj periudhe të begatë, urtësinë hyjnore në këtë veçim të tyre, sjelljen e arabëve para Islamit me këto muaj, si dhe atë çfarë duhet të bëjë besimtari musliman në këtë periudhë të çdo viti!”

Këto dhe të tjera detaje të shpjeguara me imtësi, mund t’i mësoni në minutat e këtij dersi, që Imam Muhamed B. Sytari, mbajti të xhumanë, më 10/11/2025, në xhaminë e Parrucës, Shkodër.



“TA JETOJMË E TA DËSHMOJMË ISLAMIN BUKUR E ME KRENARI!”

Ditën e enjte, më 16 janar 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, nisi ciklin e ri të ligjëratave, me rastin e Tre Muajve të Mirë, Rexheb, Shaban dhe Ramazan 1446 h.

Pas namazit të akshamit, ndalesa e parë ishte në xhaminë e fshatit Dragoç, ku iu drejtua të pranishëmve me një këshillë rreth thellimit në mësimin e fesë dhe dëshmimin e tij me urtësi e krenari.

Myftiu theksoi se besimi në Një Zot të Vetëm të gjithësisë, pa shok, pa rival, pa të ngjashëm e të plotëfuqishëm dhe distancimi nga idhujtaria dhe format e saj të shumta, është themeli kryesor i fesë islame.

Më tej, vuri theksin tek fjala e pastër, sinqeriteti, ruajtja e amanetit, përkujdesja për lidhjet farefisnore, kujdesi për komshiu, distancimi nga

haramet dhe ruajtja e jetës.

Në këtë konteskt, Myftiu përmendi edhe marrëdhëniet me të krishterët dhe jomuslimanët në përgjithësi, të cilët kanë të drejta të plota dhe të mbrojtura në mesin e muslimanëve.

Myftiu tha se përgjatë historisë, të krishterëve i janë ruajtur të drejtat e plota, përfshi kishat, priftërinjtë, kryqet dhe kanonet e tyre, bazuar mbj ajetin kur’anor: “Ju kenë fenë tuaj dhe unë kam fenë time!”

U lut që kjo periudhë të kalojë me përkushtim të madh dhe përgjegjësi, për ta jetuar e dëshmuar Islam in bukur e me krenari.

Myftiu falënderoi imamët e nderuar të fshatrave: Dragoç, Boks, Kullaj, Omaraj, Mes-Myselim, Ura e Shtrenjtë, të cilët dhanë mesazhe dhe diskutuan, duke ia shtuar vlerat kësaj mbrëmjeje të shënuar.



H. VEHBI S. GAVOÇI
(1923 - 2013)



TË MËRAT E ZEQATIT PËR PASANIKUN E PASURINË E TIJ JANË TË SHUMTA.

ZEQATI E MËSON PASANIKUN TË ZBATOJË URDRIN E ZOTIT (XH.SH), TA ADHURJË ATË ME SHPRESËN E TË MIRAVE TË TIJ DHE TË MBROJTJES. ZEQATI E MËSON PASANIKUN GJITHASHTU TË SHPENZOJË PËR HIR TË ZOTIT (XH.SH);

E MËSON TË PËRULË VETEN, TË MOS KRENOHET, TË KËRKOJË NGA ZOTI (XH.SH), QË T’I RUHET PASURIA, SHTËPIA E NJERËZIT E VET;

TË KETË MËSHIRË PËR NJERËZIT E ZOTIT (XH.SH) E T’U BËJË MIRË ATYRE; TË TREGOJË LAVDINË E ZOTIT (XH.SH) PËR TË MËRAT QË NA KA DHËNË, PËR TË SHTUAR TË MËRAT E TIJ. E NDIHMON TË HYJË NË XHENET E TË RUAJË VETEN NGA DËNIMI NË JETËN E ARDHME!



(Nga libri:
Si forcohet e si vërtetohet besimi?)



H. Sadush Tahiri
Ligjërues islam, Shkup

Pa të kuptuarit e Kur’anit ne do të jemi vetëm shkumë e pavlerë. Atë ditë që shokët e profetit e dëgjuan këtë u frikësuan shumë, dhe thanë; “O i Dërguari i Allahut, a do të bëhemi kështu, të pavlerë dhe pa dobi dhe të mbetemi në fund të popujve?”

A do të jemi valë e detit, por e pavlerë?!

Sot ne jemi duke mësuar plotësisht se çfarë tha i Dërguari i Allahut.

O i Dërguari i Allahut, sot jemi duke e parë gjurmën e Kur’anit në jetën tonë, ku xhamitë tona janë të zbrazëta nga trimat që ti i dije, ku dituria doli nga xhamitë tona, kubetë mbetën pa emra madhështie, dijetarët nuk janë më aty.

Kubeja e xhamisë emevite në Damask, që quhej “kubeja e shqiponjës”, aty ku dijetarët vërshonin dhe ku frymëmarrjet e tyre qëndronin brenda mureve të saj! Aty ishte Gazali, Neveviu dhe Ibn Tejmije, aty dolën dhjetëra dijetarë të tjerë, aty ku u dëgjua britma e fortë i

“DO TË JENI SI SHKUMA E DETIT!”

Ibn El-Xheviut në ditën kur mbi gratë e muslimanëve u ushtrua dhunë në Spanjë, që tha: “Lëkunduni o shtylla të xhamisë, lëkunduni!” Sepse atë ditë dikush kishte hequr shaminë mbi kokat e muslimaneve në Kordobë!

- Atë ditë, o i Dërguari i Allahut, ne nuk ishim shkumë deti e pavlerë!

- O i Dërguari i Allahut, ne sot jemi duke e kuptuar plotësisht realitetin që po ndodh: në shtëpitë tona sot kemi shumë stoli, shtroje të bukura, por të varfra, aty nuk kemi as një apo dy rafte për libra; por e dimë se në të kaluarën shtëpitë e Irakut ishin plot e përplot me libra të mbushura, aq sa kishte shtëpi që brenda tyre kishte 40 mijë libra, e disa, i sillnin me karvanë deveshë, aq shumë që ishin; prindi krenohej me harxhimet e bëra për bijtë e vet dhe për blerjen e mijëra vëllimeve të librave.

- Atë ditë, o i Dërguari i Allahut, ne nuk ishim shkumë deti e pavlerë!

- Numri i grave dijetare në vetëm një lagje të Andaluzisë arrinte në 170 dijetare! Buhariu dhe Shafiu i numëronin dijetarët që u jepnin mësim duke i konsideruar si copëza floriri të rrallë; Ibn Asakiri thotë se veç ky kishte arritur të merrte mësim nga 80 dijetare të njohura për mësim të thella. Atë ditë, gratë dijetare shkëlqenin si dielli në mëngjes!

- Atë ditë, o i Dërguari i Allahut, ne nuk ishim shkumë deti e pavlerë!

- O i Dërguari i Allahut, spitalet në

Egjipt çdo ditë strehonin të sëmurë dhe familjet e tyre, ku në çdo repart të spitalit kishte bibliotekë të madhe. Numri i librave në spitalin e Ibn Kulunit në Kajro arrinte në 100 mijë libra, që i sëmuri të mos çonte kohën kot dhe pa dituri; atë ditë ymeti islam kërkonte dituri edhe pse ndodhej në shtratin e vdekjes!

- Atë ditë, o i Dërguari i Allahut, ne nuk ishim shkumë deti e pavlerë!

- Imam Evzaiu u rrit jetim në prehër të nënës së tij, por ajo, prej tij bëri dijetar me famë, e edukoi me moral të lartë, dhe për të thanë: “Edhe mbretërit nuk arritën të edukojnë një të tillë, siç bëri nëna e Evzaiut!? Po kështu bëri edhe nëna e Imam Shafiu, i duroi të gjitha vështirësitë e jetës, por në djalin e vogël mbolli atë që sot, burrat e botës nuk arrijnë ta mbjellin dot; kështu ishin gratë dikur!

- Atë ditë, o i Dërguari i Allahut, ne nuk ishim shkumë lumi e pavlerë!

- E pastaj ndodhi e kundërta, o i Dërguari i Allahut, e mira sikur iku nga ne, mbeti vetëm pak, u shtua e keqja dhe e pavlera, në peshoren e qiellit u bëmë të pavlerë, sikur një gjeth i thatë, ndërsa në peshoren e njerëzimit u bëmë shkumë deti! Nuk do të ishim kështu nëse do ta kuptonim Kur’anin siç duhet, në mënyrë që ai të jetë shqetësimi dhe udhërrëfyesi ynë në jetë, që me të, të arrinim nderin e lartë të dëshmisë para botëve dhe prezencën e fuqishme në skenën botërore!

“Do të jeni si shkuma e detit!”



Dr. Mustafa Mahmud

PËRSE E FALSIFIKOJNË HISTORINË?

Përse ubashët zgjasin gjuhët e tyre ndaj Buhariut, Muslimit dhe Ukbe ibn Nafiut dhe jeta e tyre fshihet nga programet mësimore...?!

Përse shkrimtarët myslimanë shkruajnë në histori për jomuslimanët, dhe kur shkruajnë për ta, shkruajnë me plotë etikë, me syrin e vlerësimit dhe me superlativa, ndërsa për ata, të cilët kanë çelur vendet dhe kanë çliruar njerëzit, e kanë përhapur drejtësinë e barazinë mes njerëzve, nuk përmendin fare për ta?!

A është kjo gjë e qëllimshme, që të humbasim pak nga pak identitetin tonë mysliman, derisa të zhvishemi prej tij dhe të formohet një brez myslimanësh, që nuk dinë asgjë prej Islamit të tyre..?!

A është qëllimi prej kësaj, të përhapet imoraliteti, shturja, veset e këqija dhe mos përhapja e dijes së saktë..?!

Perëndimi nuk ka heronj të vërtetë në historinë e tij, për këtë arsye do të gjesh, se ata u mësojnë bijve të tyre personalitet imagjinare! Dhe, u prodhojnë atyre filma për Batmanin, Spidermanin apo Supermanin dhe ua shfaqin sikur ata mbrojnë tokën dhe vendin e tyre, Amerikën!

Ua mësojnë fëmijëve të tyre këta personalitete imagjinare dhe e lënë historinë tonë madhështore, në të cilën do të gjesh komandantin më të madh ushtarak të historisë, Halid ibnul-Velidin, që mposhti perandorinë romake dhe persiane vetëm për 5 vjet,

dhe vetëm në betejën e Mu'tes u thyen tetë shpata nga dora e tij..!!

Në betejën e Jermukut, është një sahabi tjetër, quhet Dirar ibnul-Ezur, romakët e quanin "djalli gjoks hapur", sepse ai (Allahu qoftë i kënaqur me të), përpara betejës vrau në duele 20 komandantë të tyre, njërin pas tjetrit, dhe kështu ua shkërmoqi moralin e tyre..!!

Këto heroizma nuk munden t'i realizojnë, qoftë edhe nëpër filmat e tyre!

Kështu, edhe El-Kaëka ibn Amër Et-Temimi (r.a), që kur qëndronte në ballë të ushtrisë, kjo do të thoshte, se ai kishte fituar. Ebu Bekri (r.a) thoshte për të: Nuk mposhtet një ushtri, në të cilën është El-Kaëka, përbindësh i vërtetë..!!

Jusuf ibn Tashfin, e zemëruan dhe u ngrit për Andaluzinë, ndërkohë ai ishte në moshën 83 vjeç, triumfoi ndaj kryqëzatave me një triumf dërrmues shkatërrues ndaj tyre dhe e vonoi rënien e Andaluzisë për katër shekuj. Pastaj, u kthye në shkretëtirë për të vazhduar jetën e tij..!!

Komandanti Musa ibn Nusejr, çalonte në kohën kur mori veriun e Afrikës dhe Andaluzinë..!!

Mehmet Fatihu, që lëvizi anijet në tokë dhe ata nuk e besuan këtë lajm, derisa e panë rrugëve të tyre, që kishte marrë Kostandinopojën, e cila ishte e pamundur të merrej..!!

Harun Reshidi, që një vit shkonte në Haxh dhe vitin tjetër shkonte në luftë.

Omer ibn Abdulazizi në shtetin Emevit, që sundonte që nga Kina e India deri në Andaluzi, dhe përhap drejtësinë në to mbarë..!! Thoshte: Hidheni grurin në maja të maleve gjithashtu, që të mos thuhet: Ka qenie që janë të uritura në kohën e Omer ibn Abdulazizit..!!

Mensur ibn Ebi Amir, nuk ka lënë rob mysliman në burgjet e jobsimtarëve, por i kishte liruar të gjithë, ku me të, Allahu bëri krenar myslimanët duke hyrë në 54 betejat pa pësuar disfatë absolutisht në asnjë prej tyre..!!

Alp Arslan (Allahu e mëshiroftë), ku Papa i Vatikanit kishte mbledhur nga të katër anët e Evropës një ushtri me 200 mijë ushtarë, për t'u nisur në fushatën e dytë të kryqëzatave dhe u ndesh me ushtrinë selxhuke të myslimanëve, e cila kishte vetëm 20 mijë ushtarë, dhe fitoi kundër tyre me një fitore shkatërrimtare, derisa madje zunë rob perandorin e romakëve për herë të parë në histori!!

Mahmud El-Gazneviu (Allahu e mëshiroftë), mori Indinë dhe në të gjeti një idhull të madh, ku njerëzit mblidheshin rreth tij prej të katër anëve, (pozita e tij tek ata ishte sikur Qabja te ne), numri i atyre që i shërbenin arrinte 50 mijë persona, dhe triumfoi ndaj të gjithë atyre. Ata e tunduan duke i ofruar pasurinë e dynjasë, që të mos ua thyente idhullin e çuditshëm; mendoi pak, pastaj tha: Kur Allahu të më thërrasë në ditën e kiametit, kam dëshirë të më thërrasë: Ku është Mahmudi, që ka thyer idhullin dhe jo ku është Mahmudi, që ka lënë pa thyer idhullin kundrejt pasurisë..!!

Kur triumfatori Ukbe in Nafi (r.h) mbërriti me kalin e tij në oqeanin Atlantik, derisa kalit u zhyten këmbët në ujë, thirri me zë të lartë, duke thënë: O Zoti im, dëshmo se unë e bëra mundin tim, dhe sikur të mos ishte deti, do të kisha vazhduar duke luftuar ata që të kanë mohuar, derisa të mos adhurohet dikush tjetër, përveç Teje! Dhe, pastaj mori rrugën e kthimit.

Këta të tillët janë heronjtë tanë të vërtetë. Mësojuani fëmijëve tuaj, sepse nuk jemi si ata, që nuk kanë histori të tyre, siç përpiqen të na hipnotizojnë me këtë gjë, në mënyrë që të na shkatërrojnë, pastaj të na skllavërojnë...

Ai që nuk ka histori, për të nuk ka as të ardhme!

*Nga libri: Shejtani sundon,
i Dr. Mustafa Mahmud*

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

PRITA SOT, NË NJË TAKIM LAMTUMIRE, ARQIPESHKVIN SHKODËR-PULT, MONS. ANGELO MASSAFRA

Me zotninë e tij njihemi prej dekadash, aq sa, kur e kthej kokën pas, duket se nuk e kap dot fillin e takimit tonë të parë. Ndërkohë, nga asokohe e deri më sot, kanë kaluar dekada e vite, në krahët e të cilëve, ne kemi mbajtur qëndrime të shumta, herë të afërta e herë të largëta, por asnjëherë larg boshtit të asaj që të dy ne përfaqësojmë, bashkarisht e të ndarë!



Në këto vite të gjata të njohjes, në tryezat e takimeve dhe bashkëpunimeve tona, nuk ishim vetëm, teksa doradorës me hoxhallarë e priftërinj të nderuar, përhapëm dritë e mesazhe të ekuilibruara, në shërbim të komunitetit, qytetit e asaj që trashëgojmë ndër shekuj!

Do të dëshiroja, që agjenda e takimeve dhe bashkëpunimeve të ishte më e ngjeshur, më e ngarkuar me atë që NE mund e duhet të japim në vazhdimësi, por që nganjëherë, mbetet e heshtur përballë përzgjedhjeve dhe qëndrimeve që po NE vendosim t'i japim pozicion në listën e përparësive.

Tashmë, mons. Massafra do të largohet nga Shkodra e, misioni ynë vazhdon në ruajtjen e bashkëjetesës, në forcimin e harmonisë, në kultivimin e asaj që ia kemi për borxh besimit, fesë, atdheut, kombit tonë dhe kujtdo, që sikurse NE, e ka vullnetin e dëshirën që të mos ngelet peng i cytjeve të shejtanit e i provincializmit të ngurtë e fanatik, verbërisht fanatik!

I urova mons. Massafra çdo të mirë, shëndet e jetë të gjatë, plot vepra të mira, për të cilat Zoti është razi, sikurse e falënderova për atë që bashkarisht,

ditëm ta përcjellim bukur, me lutjen që Zoti të na falë për ç'ka mund ta kishim bërë edhe më mirë në këtë rrugëtim të gjatë, të veshur me petkun e të natyrshmes e njerëzores, që përtej çdo dëshire prej dëshirave tona, ngelet e mangët!

Ishte një nderje, që mblodhi në minutat e saj, krejt vitet e bashkëpunimit, dëshirat e vullnetet e mira, që u shkruanë në një dhuratë

simbolike, që ia dhurova me shumë dashamirësi arqipeshkvit Massafra, në një foto që na lidh të gjithëve dorë për dorë, në një Shtëpi prej shtëpive të Zotit!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër





DR. SALAHUDIN KEFTARO
Damask, Siri

“

Zoti ynë

është Mëshirues,

Mëshirëbërës;

*Nuk na ka krijuar
për të na ndëshkuar;*

*Por që ta duam
Atë dhe Ai të na dojë;*

*Të na mëshirojë
dhe të na hapë rrugët,
që të marrim pjesë në
ndërtim dhe në zhvillim*

*me mbarësinë
dhe razinë e Tij!*



MYFTIU SYTARI NË MESIN E VËLLEZËRVE NË INGOLSTADT TË GJERMANISË

Me ftesë të Bashkësisë Islame “ASR” e.V. Ingolstadt, kryetarit të saj, H. Mirsad Dervishi dhe imanit të nderuar, Hfz. Xhelal Kaloshi, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, ligjëroi rreth kuptimeve dhe mesazheve të Natës së Israsë dhe të Miraxhit, në aktivitetin që u zhvillua në Ingolstadt të Gjermanisë, ditën e diel, më 26 janar 2025.

Në ligjëratën e tij, Myftiu i Shkodrës, u ndal tek mesazhet madhore të përkujtimin të mrekullive të Israsë dhe të Miraxhit.

Ai theksoi se me obligimin e pesë vakteve ditore të namazit, Israja dhe Miraxhi u bënë hartë jete dhe sistem organizimi për jetën e muslimanit.

Ai tha se, pozita e lartë, me të cilën Zoti i gjithësisë bekoj Hz. Muhammedin (a.s.), është thirrje e përditshme për çdo musliman për të qenë dikushi në jetë.

Gjithashtu, vuri theksin tek domosdoshmëria e ruajtjes së harmonisë dhe vëllazërisë në mesin



e muslimanëve, si dhe përhapjen e mesazheve universale të Islamit, me këdo prej krijesave të Allahut, duke marrë mësim nga takimi i Hz. Muhammedit (a.s) me krejt pejgamberët dhe falja e tij imam para tyre.

Myftiu Sytari falënderoi mikpritjen dhe ftesën bujare të kryetarit Dervishi, sikurse shprehu kënaqësinë e takimit me imamin e nderuar dhe bilbilin e leximit të Kur'anit, me famë botërore, Hafiz Xhelal Ef. Kaloshi.



MYFTIU SYTARI: “RUAJENI HAKUN E KOMSHIUT, DËSHMOJENI DRITËN E ISLAMIT!”

Në kuadër të ciklit të ligjëratave: “Tre muajt e mirë dhe thirrja e besimit!”, që Myftiu i Shkodrës po zhvillon në atmosferën e Tre Muajve të Mirë, ditën e enjte, më 30 janar 2025, pas namazit të akshamit në xhaminë e fshatit Mjedë u zhvillua ligjërata e radhës.

Pas faljes së namazit të akshamit, që u drejtua nga H. Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, fjalën e rastit e mbajti imami i xhamisë së fshatit Mjedë, H. Asllan Babaj, i cili pasi uroi mirëseardhjen e Myftiut shprehu kënaqësinë e tij dhe të xhematit për përfshirjen e xhamisë së Mjedës në këtë projekt të dobishëm për mbarë komunitetin.

Në ligjëratën e mbajtur në këtë mbrëmje të begatë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari u ndal të rëndësia që ka respektimi i hakut të komshiut në jetën tonë të përditshme, si dhe ruajtja e tabanit të baballarëve të shkuar.

Myftiu theksoi se ajetet e shumta kur'anore dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s) janë argumenti më i madh



që vërteton madhësinë e Islamit në raportet e njeriut me komshinjtë e tij.

Myftiu vuri theksin edhe tek ajo që e quajti agjenda e tjetërsimit të tabanit, që është prishja e shtëpive të vjetra dhe e trashëgimisë islame në qytetin e Shkodrës dhe zëvendësimi i tyre me banesa dhe pallate të reja. Ai theksoi se devijimi nga tabani i të parëve, ku dikur njerëzit shkonin dhe vinin te njëri-tjetri, ku shtëpitë ishin më të përshtatshme për të prituri dhe për t'i shkuar dikujt, është në të vërtetë përpjekje për të rrëshqitur drejt shoqërive të ngushta, të mbyllura, egoiste, pa besim, pa shpirt dhe pa

ndjenjën e të jetuarit në komunitet.

Ai tha se në Islam haku i komshiut është i shenjtë dhe i ruajtur, ku nëpërmjet haditheve të ndryshme hodhi dritë mbi nxitjen që i bën i Dërguari i Allahut (a.s) besimtarëve për të dashur për komshiun dhe për tjetrin atë që duan për veten tonë, si dhe nxitjen që bëhet për ta ruajtur komshiun nga e keqja e mundshme që mund t'i vijë nga gjithsecili prej nesh.

Ligjërata e Myftiut mbledhi të rinj e të reja, si dhe besimtarë të shumtë që prezantuan në xhaminë e Mjedës në këtë mbrëmje të begatë.

TAKIM DHE VEPRIMTARI ME NXËNËSIT E MEJTEPIT TË XHAMISË SHIRQ-MUSHAN

Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit zhvilloi më 31 janar 2025, pas namazit të xhomasë, një takim me nxënësit e mejtepit të xhamisë Shirq-Mushan, në prani të imanit të përkushtuar dhe të palodhur, H. Kujtim Cufaj.

Përgjegjësi i arsimit, teologu Arben Halluni i pranishëm në organizimin e këtij takimi, fillimisht zhvilloi një bisedë fetare, ku foli për rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i kurseve



fetare, sidomos me fëmijët dhe brezin e të rinjve, dhe në këtë kontekst kërkoi më shumë bashkëpunim edhe nga ana e prindërve për të edukuar bashkërisht fëmijët e tyre me frymën e besimit, të adhurimit dhe moralit më të mirë islam.

Kjo veprimtari arsimore, në të cilën u zhvillua edhe një konkurs fetar në mes të nxënësve, u mbyll me shpërndarjen e dhuratave për secilin nxënës dhe nxënëse si dhe me një koktejl të përgatitur enkas për këtë rast.

JUNNANI (NJË PROVINCË NË JUGPERËNDIM TË KINËS)

Junnan (Yunnan) është një provincë në jugperëndim të Kinës, pa dalje në det, dhe kufizohet me provincat kinëze Guizhou dhe Siçuan (Sichuan), me rajonet autonome Guangxi (Guangxi) dhe Tibet, si dhe me vendet e Azisë Juglindore: Vietnamin, Laosin dhe Mianmarin.

Provinca ka një sipërfaqe afërsisht 436,200 km², dhe një popullsi prej 48.3 milion banorësh (viti 2018).

Kryeqyteti i provincës është **Kunming**.

GJEOGRAFIA

Junnan është provinca më jugperëndimore e Kinës. Terreni i Junnan-it është kryesisht malor, veçanërisht në veri dhe në perëndim. Një seri vargmalesh të larta janë të shpërndara në të gjithë provincën. Pjesa perëndimore e provincës ka terren kanionik, kurse pjesa veriore është pjesë e rrafshnaltës Junnan-Guizhou. Lumenjtë kryesorë të Junnanit rrjedhin nëpër luginat e thella midis maleve.

Lartësia mesatare e provincës është 1,980 m mbi nivelin e detit. Malet janë më të larta në veri ku arrijnë më shumë se 5,000 m lartësi, kurse në jug ato janë jo më shumë se 3,000 m. Pika më e lartë në veri është maja Kauagebo, e cila është rreth 6,740 m mbi nivelin e detit dhe më e ulëta është në luginën e lumit të Kuq në Qarkun Hekou, pranë kufirit me Vietnamin, me një lartësi prej 76.4 m.

Pjesa lindore e provincës është një pllajë gëlqerore me pamje karstike dhe me lumenj të palundrueshëm, që rrjedhin nëpër gryka të thella malore. Pjesa perëndimore karakterizohet nga vargmalet dhe lumenjtë që rrjedhin nga veriu dhe jugu. Këtu përfshihen lumenjtë Nu Xiang, Lancang dhe Xhinsha, të cilët rrjedhin shumë afër njëri-tjetrit në zonën e mbrojtur të "Tre Lumenjve Paralele". Terreni i thyer dhe vertikal krijon një gamë të gjerë flore dhe faune dhe rajoni është quajtur një kopsht natyror zoologjik dhe botanik.

Në Junnan gjenden një numër liqenesh ku nëntë prej tyre kanë një sipërfaqe më të madhe se 30 km², si liqenet Lugu, Diançi, Fuxian, Xingiu, etj.

KLIMA

Pavarësisht se gjendet në tropikun e veriut, rajoni i rrafshnaltës lindore

të Junnanit shquhet për temperatura të moderuara. Për shkak të lartësisë së madhe, verat janë të freskëta dhe dimrat të butë. Temperatura mesatare qershor-korrik është 22 °C, dhe temperatura mesatare dhjetor-janar 9 °C.

Në rajonin e kanionit perëndimor, malet e larta dhe luginat e thella krijojnë zona klimatike vertikale. Në fund të luginave mbizotëron nxehtësia e fortë me lagështi të lartë. Lartësitë 1,830 - 3,350 metra karakterizohen nga klima e butë, kurse majat e maleve mbështillen nga erërat e acarta.

Nën ndikimin e erërave musone që



bartin shi dhe që fryjnë nga oqeani Paqësor dhe Indian, Junnani gëzon reshje të mira kryesisht të shiut. Pjesa më e madhe e shiut bie nga maji deri në tetor, ku më shumë reshje bien në rajonin e kanionit perëndimor sesa në rajonin e pllajës lindore. Reshjet mesatare vjetore në Kunming (kryeqyteti, që gjendet në anën lindore të provincës) janë rreth 1,245 mm, ndërsa në Tengchong (në Junnanin perëndimor) janë rreth 1,475 mm.

EKONOMIA

Megjithëse vetëm rreth 6 % e tokës së Junnan-it është e punueshme, variacionet e gjera klimatike i sigurojnë provincës kultivimin e një shumëllojshmërie

kulturash. Orizi është deri tani drithi ushqimor bazë, më i rëndësishmi i kultivuar në Junnan. Në fushat malore, në luginat e hapura dhe në faqet e kodrave me tarraca, orizi është kultura kryesore verore, me misrin, si një kulturë dytësore të rëndësishme. Të lashtat e tjera verore përfshijnë patatet e ëmbla, perimet, kallam sheqerin dhe çajin. Në rajon prodhohen gjithashtu gruri, elbi, fasulet, bizelet dhe farat e rapit, pambuku dhe kërpi, pjeshkat, hurmat, arrat dhe gështenjat. Në skajin jugor të vendit, veçanërisht në luginat e ulëta, rriten banane, arra kokosi dhe kafe.

Çaji nga Pu'er ka një reputacion mbarë botëror.

Nga llojet e bagëtive që mbarështohen në Junnan janë: bualli i ujit, poni, mushkat, lopët, delet, dhitë, etj.

Rajoni i luginës perëndimore ka rezerva të mëdha druri që mbulojnë rreth një të katërtën e sipërfaqes së Junnanit dhe është ndër rezervatat më të mëdhenj drusorë në Kinë.

Provinca ka disa nga depozitat më të mëdha të kallajit në botë. Kallaji nxirret në pjesën juglindore të provincës dhe në perëndim të lumit Lancang. Junnani është gjithashtu një prodhues i madh i bakrit (i cili nxirret kryesisht në rajonin Huizi), plumbit dhe zinkut (në Lanping,

në Junnanin perëndimor). Provinca Junnan ka depozita të moderuara të qymyrit dhe hekurit. Përveç kësaj, disa rezerva naftë dhe gazi natyror janë zbuluar në zona të caktuara në pjesët jugperëndimore dhe lindore të provincës. Produkte të tjera minerale përfshijnë antimonin, tungstenin, merkurin, fosforin, argjendin, arin aluvial, kinabarin (xeheror i merkurit) dhe manganin.

Prodhimi i energjisë elektrike është gjithashtu një komponent i rëndësishëm i ekonomisë së provincës. Energjia prodhohet nga termocentralet dhe, gjithnjë e më shumë, nga hidrocentralet. Provinca Junnan prodhon energji elektrike të tepërt, e cila eksportohet në provincat fqinje.

Pas vitit 1949 Junnani përjetoi rritje të konsiderueshme industriale. Zona Kunming është zhvilluar në një kompleks industrial gjigant i përbërë nga mullinjtë çeliku, objekte të shkrirjes së hekurit dhe bakrit, si dhe fabrika që prodhojnë plehra, makineri, kamionë, automobila, kimikate industriale, instrumente optike, tekstile dhe ushqime të përpunuara.

GJUHA

Gjuha zyrtare e Junnan-it është Kinezishtja standarde.

Junnan është shtëpia e shumë grupeve minoritare, të cilët kanë secili gjuhën e tyre të ndryshme, prandaj konsiderohet si shtëpia e një morie dialektesh, që rrjedhin nga familjet e gjuhëve kineze, tibetiane dhe tajlandeze.

Qytetet lokale kanë shpesh versionin e tyre të gjuhës Mandarin, të cilat janë nën-dialekte të dialektit jugperëndimor të Mandarinit të përbashkët që flitet në Junnan, Guizhou dhe Siçuan. Pavarësisht theksit të rëndë, dialekti lokal i gjuhës kineze është shumë i ngjashëm me Mandarinin verior, me shumë pak dallime të vogla rajonale në gramatikë dhe shqiptim.

FEJA

Sipas një analize demografike të feve në Junnan (të bërë në vitin 2005), pothuajse 90% e popullsisë nuk ndjekin asnjë besim fetar, 6% e popullsisë së përgjithshme janë budistë, 1.4% janë muslimanë, 1.2% protestantë, 0.5% taoistë, 0.1% katolikë, etj.

Kurse sipas statistikave të regjistrimit të gjashtë, të bërë në vitin 2010, Junnan-i ka një popullsi muslimane prej 1.09 milionë banorësh, dhe më shumë se 867 xhami janë të shpërndara në të gjithë provincën.



KRYEQYTETI, KUNMING

HISTORI

Në antikitet, Junnan-i banohej nga grupe indigjene që nuk ishin pjesë e qytetërimit kinez Han. Ata ranë nën sundimin kinez vetëm në kohën e dinastive Kin (221–207 p.e.s) dhe Han. Edhe pas kësaj, pushteti qeveritar mbeti në duart e krerëve të fiseve, dhe kolonët kinezë depërtuan vetëm në pjesët lindore të provincës. Në vitin 109 p.e.s. në atë rajon hanët kinezë krijuan prefekturën Jizhou. Nën dinastinë Tang (618–907 e.j) në rajonin Dali lulëzoi mbretëria Dai, e njohur si Nanzhao. E krijuar fillimisht si një mburojë kundër depërtimeve tibetiane, mbretëria Nanzhao u bë një kërcënim për fuqinë kineze, por gjatë periudhës së Pesë Dinastive (907-960) dhe dinastisë Song (960-1279), ajo ra përfundimisht.

Gjatë dinastisë Juan (mongole, vitet 1206–1368), situata e rajonit ndryshoi. Në vitin 1253 mongolët e shkatërruan përfundimisht mbretërinë Nanzhao. Ata e emërtuan Junnan atë rajon, dhe e bënë atë një provincë të Kinës Juane, në vitin 1276. Për të ribanuar Junnanin, i cili ishte shpopulluar nga lufta, guvernatori solli një numër të madh të etnisë Hui (myslimanë kinezë) nga Kina veriperëndimore.

Sundimtarët e dinastisë Ming (1368-1644), duke kërkuar të forcojnë kontrollin e tyre mbi provincë, përdorën njësi ushtarake për të nxitur migrimin e popullit kinez nga lugina e lumit Jangtze për në Junnan. Provinca qeverisej nëpërmjet një sistemi 'tusi' të trashëguar - që do të thotë: udhëheqës lokalë që shërbenin si agjentë të magjistratëve kinezë. Kjo politikë e sundimit indirekt vazhdoi edhe gjatë kohës së dinastisë King (1644–1911/12) dhe republikës (1911–49), kur u ndërmorën përpjekje për ta vënë provincën nën kontrollin e qeverisë qendrore më tërësisht.

Gjatë shekullit të 19-të, Junnani ra viktimë e imperializmit britanik dhe francez. Franca që zuri vend në Vietnam, e konsideroi Junnanin si brenda sferës së saj të influencës dhe në fund të shekullit të 20-të ajo ndërtoi hekurudhën Hanoi-Kunming, për të shfrytëzuar burimet e provincës. Në vitin 1910, britanikët që kishin zënë vend në Birmani, e detyruan tusin e Pianmës (Hpimau) të largohej dhe më pas ata e pushtuan Junnan veriperëndimor që ishte territori i tij.

SI ERDHI ISLAMI NË JUNNAN

Lidhur me epokën kur Islami u fut në Junnan, ekzistojnë dy teori: teoria e hyrjes së Islamit atje gjatë dinastisë Tang, dhe teoria e prezantimit të Islamit atje gjatë dinastisë Juan (mongole). Teoria e hyrjes së Islamit atje gjatë dinastisë Tang është ende e vështirë për t'u verifikuar, për shkak të të dhënave të pamjaftueshme historike për këtë. Historianët përgjithësisht besojnë se në vitin 1253, Kublai Khan u urdhërua të sulmonte Junnanin. Ai komandoi 100,000 trupa ushtarake elitare mongole në këtë betejë, dhe kjo ishte koha kur filloi hyrja e një numri të madh të popullsisë Hui (muslimane) në Junnan.

Në vitin 1274 e.j, Sai Diançi (Sejid Exhel Shems Ed-Din Omer El-Buhkari), një politikan i shquar musliman në dinastinë Juan, u zgjodh nga Kublai Khan (perandori i dinastisë Juan), për të shërbyer si guvernator i Provincës së Junnanit. Si politikan dhe një musliman i shquar, Sai Diançi zbatoi një sërë masash politike, ekonomike dhe kulturore në Junnan, si krijimin e qeverisë rrugore, bashkimin e qeverisë, promovimin e ruajtjes së ujit, barazimin e taksave, ndërtimin e depove, hapjen e rrugëve postare, ndërtimin e xhamive dhe krijimin e shkollave falas. Në të njëjtën kohë, ai përhapri Islamit në Junnan.



XHAMIA E MADHE NË SHADIAN, KUNMING

Sipas legjendës, Sai Diançi themeloi 12 xhami në Shançan (Kunming-u i sotëm). Sipas Junnan General Chronicles, xhamia Nançeng dhe xhamia Jongning në Kunming, të dyja këto u ndërtuan nga Sai Diançi. Në vitin 1279, eksploratori italian Marko Polo, kur po udhëtonte në Junnan, ai pa se Kunming ishte: "...Një qytet i madh dhe i shtrenjtë, me shumë tregtarë dhe punëtorë. Atje ka disa lloje njerëzish. Atje ka myslimanë, idhujtarë dhe disa të krishterë nestorianë". Marko Polo përmendi fillimisht se: "Atje ka myslimanë.", nga ku mund të nxjerrim përfundimin për numrin e madh të myslimanëve në Junnan gjatë Dinastisë Juan.

Sipas kronikave dhe mbishkrimeve lokale të Junnanit: Gjatë dinastisë Ming, ata hynë në Kunming dhe Çushiongun e sotëm, në Dali, Weishan, Jongping, Baoshan dhe Tengçong në perëndim. Ata hynë në Juxi, Tonghai, Huaning, Kaijuan, Gexhiu, Jianshui dhe Shih në jug të Kunmingut. Vendbanime Hui-muslimane gjenden në Ping, Maitreja, Janshan, Songming, Xundian, Zhani, Kuxhing dhe vende të tjera në lindje të Kunmingut, ndërkohë që një rajon i gjerë vendbanimesh të vogla të shpërndara Hui ishte formuar më përpara gjatë dinastisë Juan. Një numër i madh ushtarësh, emigrantësh dhe biznesmenësh Hui hynë në Junnan gjatë dinastisë Ming gjithashtu. Popullsia Hui u rrit dhe Islami u përhap më gjerësisht.

Gjatë kohës së dinastisë King, Islami në Junnan u integrua gradualisht me kulturën tradicionale kineze, duke filluar të formojë Islamin e Junnanit, me karakteristika lokale multietnike. Manifestimet e tij ishin zhvillimi i arsimit dhe formimi i shkollës së Junnanit, shfaqja

e klasikëve të përkthyer kinezë dhe prosperiteti i aktiviteteve akademike. Por, intensifikimi i diferencimit etnik, politikave të diskriminimit etnik të ndjekura nga qeveria King dhe shtypja që qeveria King i bëri kryengritjes së popullsisë Hui në Junnan (në fund të epokës së dinastisë), të gjitha këto e penguan zhvillimin e popullit Hui në Junnan, dhe zhvillimi i Islamit gjithashtu pësoi një goditje.

Në vitin 1872, pas dështimit të kryengritjes së popullsisë Hui në Junnan, kjo popullsi u detyrua të fillonte aktivitete të mëdha migrimi. Ky zhvillim e intensifikoi shpërndarjen e myslimanëve në Junnan në shkallë të gjerë, në të gjithë vendin, duke krijuar kudo vendbanimeve të vogla të tyre. Me migrimin në shkallë të gjerë të popullsisë Hui, Islami u ruajt dhe u soll në të gjitha pjesët e provincës, madje edhe deri në Mianmar, në Siamin (Tajlandë) ngjitur me Junnanin, dhe në vende të tjera.

Gjatë Republikës së Kinës, Islami në Junnan filloi të lëvizte drejt një faze të re zhvillimi. Nga njëra anë, ai hyri në shoqëri dhe ishte i përkushtuar ndaj çlirimit kombëtar dhe revolucionit demokratik, dhe nga ana tjetër, zbatoi reformën fetare, themeloi grupe fetare, themeloi dhe botoi në mënyrë aktive gazeta dhe revista periodike, themeloi shkolla të reja dhe dërgoi jashtë shtetit studentë, të cilët krijuan një atmosferë të re dhe formë të re zhvillimi të kulturës islame në vend. Pas themelimit të Kinës së Re, Qeveria Popullore garantoj lirinë e besimit fetar. Sipas statistikave, në vitin 1955, në provincën Junnan kishte më shumë se 490 xhami dhe më shumë se 1300 imamë. Por, gjatë Revolucionit Kulturor, Islami në Junnan, si fetë e tjera, u dëmtua rëndë. Xhamitë u mbyllën, u tjetërsuan,

ose u shkatërruan. Veprat klasike islame u dogjën dhe myslimanët u diskriminuan dhe u persekutuan.

Që nga viti 1978, qeveria kineze filloi politikën e lirisë së besimit fetar dhe Islami në Junnan hyri në rrugën e zhvillimit normal. Në vitin 1984 u krijua Shoqata Islame e Provincës Junnan. Në vitin 1987 u themelua Kolegji Islam i Kunmingut. Deri më tani, Junnani ka rreth 1.6 milion qytetarë myslimanë (mund të jenë edhe më shumë, pasi statistikave nuk janë të sakta), 2.259 imamë, hatibë dhe 853 xhami. Shumë qendra islame janë hapur dhe restauruar, duke plotësuar kështu nevojat e myslimanëve për një jetë normale fetare. Më shumë se 8600 myslimanë nga Junnani kanë vizituar Arabinë Saudite, për pelegrinazhin e Haxhit, dhe 94 studiues të Islamit janë kthyer nga studimet jashtë vendit. Shumica e myslimanëve në Junnan janë patriotë dhe fetarë, dhe kontribuojnë për stabilitetin e kufijve të Junnanit, për unitetin etnik dhe harmoninë fetare.

Së fundi, Islami në Kinë është vënë në shënjestër nga politikave të qeverisë. Partia ka mbyllur sistematikisht, shkatërruar ose riformuluar me forcë xhamitë në enklavat Hui, në të gjithë vendin, duke dënuar tiparet arkitekturore arabe, si kupolat dhe minaret, që sipas tyre janë provë e ndikimit të huaj të padëshiruar mbi Islamin në Kinë.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://en.wikipedia.org>
<https://www.britannica.com>
<http://www.norislam.com>
<https://u.osu.edu>

MYFTIU I SHKODRËS VIZITON REKTORIN E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS

Paraditën e ditës së hënë, më 13 janar 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një vizitë zyrtare në Universitetin e Shkodrës, "Luigj Gurakuqi", ku u prit nga Rektori, Prof. Dr. Tonin Gjuraç.

Myftiu pasi ka uruar Rektorin Gjuraç për detyrën e tij, diskutoi për mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucionit fetar dhe atij akademik.

Ky takim synon të forcojë lidhjet ndërmjet dy institucioneve dhe të



hapë rrugë për projekte dhe aktivitete të përbashkëta shkencore në fusha me interes të ndërsjellë.

Rektori Gjuraç vlerësoi rolin e Myftinisë Shkodër në promovimin e vlerave shpirtërore, humanizmit dhe të ruajtjes e kultivimit të mëtejshëm të harmonisë sociale e ndërfaqetare në

Shkodër dhe më tej. Ai theksoi gjithashtu kontributin e shquar të personaliteteve nga komuniteti mysliman në fusha të ndryshme, si arsimit, arti, kultura dhe shkenca.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari i dhuroi Universitetit enciklopedinë me libra: "Islami nëpërmjet Haditheve" si dhe botimin gazetës "Udha Islame", viti 2024, organ mediatik i Myftinisë Shkodër.

MYFTIU TAKON DISA IMAMË PËR AKTIVITETET E TRE MUAJVE TË MIRË



Paraditën e mërkurës, më 15 janar 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari së bashku me disa anëtarë të stafit të Myftinisë zhvilloi një takim pune me imamë të xhamive, në të cilat do të zhvillohet cikli i ri i ligjëratave me rastin e Tre Muajve të Mirë, Rexheb, Shaban dhe Ramazan, 1446/2025.

Përveç saj, Myftiu u interesua edhe për jetën fetare në këto xhami, rreth aktiviteteve të tyre sidomos në aspekt

të Thirrjes Islame, të edukimit të fëmijëve, si dhe diskutoi mbi çështje të ndryshme që lidhen me mirëmbajtjen e xhamive, me komunitetin që shërbejnë dhe veprimtarinë fetare në përgjithësi.

Myftiu kërkoi që angazhimi i çdo imami të rritet gjithnjë e më tepër në aspekt të përbashkëta misionare në shërbim të besimtarëve. Sikurse, u diskutua për ruajtjen e tabanit shekullor islam, kontaktet me emigrantët bashkatdhetarë

që jetojnë në vende të ndryshme të botës dhe zhvillimin me ta, sipas mundësive, të kurseve dhe ligjëratave të ndryshme fetare, duke shfrytëzuar edhe rrjetet sociale dhe teknologjinë.

Kujtojmë, se ky cikël ligjëratash do të mbahet nga Myftiu i Shkodrës në këto xhami: Dragoç, Vukatanë, Mjedë, Kuç, Shkvezë, Shtuf dhe Melgushë, sipas një programi të afishuar për të interesuarit.

Tre Muajt e Mirë
DHE THIRRAJA E BESIMIT
 Cikël ligjëratash nga Imam Muhamed B. Sytari me rastin e Tre Muajve të Mirë: Rexheb, Shaban dhe Ramazan 1446/2025

Nr.	Xhamia	Data
(Çdo të enjte, pas orës 16:45)		
1	Dragoç	16.01.2025 Ora: 16.45
2	Vukatanë	23.01.2025 Ora: 16.54
3	Mjedë	30.01.2025 Ora: 17.02
4	Kuç	06.02.2025 Ora: 17.11
5	Shkvezë	13.02.2025 Ora: 17.20
6	Shtuf	20.02.2025 Ora: 17.28
7	Melgushë	27.02.2025 Ora: 17.37

Myftinia Shkodër

ZHVILLOHET MBLEDHJA E RAPORTIT TË PËRGJITHSHËM PËR AKTIVITETIN E VITIT 2024

Paraditen e së mërkurës, më 15 janar 2025, në ambientet e Myftinisë Shkodër, Myftiu Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një takim të paralajmëruar pune me pjesëtarët e stafit, ku në rend të ditës ishte analiza e plotë e aktivitetit të Myftinisë Shkodër me krejt sektorët e saj për vitin 2024.

Në krye të herës, Myftiu lajmëroi se viti 2025 është vit jubilar për Myftininë e Shkodrës, pasi më 16 nëntor të këtij viti shënohet edhe 35 vjetori i rihapjes së xhamisë së Plumbit, që shënoi edhe rënien e diktaturës komuniste dhe lirinë e besimit, por jo vetëm, në vendin tonë.

Myftiu theksoi se në logon e këtij viti jubilar është shënuar: 35 vjet – **“Rimëkëmbje në hartën e tabanit!”**, duke vënë theksin te domosdoshmëria dhe angazhimi maksimal që duhet të tregojnë drejtuesit e sektorëve, imamët dhe të gjithë punonjësit e Myftinisë Shkodër për të dëshmuar një vit plot angazhime në drejtim të ruajtjes dhe forcimit të tabanit dhe vlerave shekullore islame të ruajtura dhe të trashëguara në qytetin e Shkodrës, por jo vetëm.

Më pas Myftiu i dha fjalën përgjegjëse të sektorëve të ndryshëm, me ç’rast dëgjoji nga gjithsecili prej tyre raportin vjetor me arritjet, por edhe me



mosrealizimet e këtij viti.

Aktivite të larmishme, shumësia e takimeve, ligjëratave, këshillave fetare, pritja e vizitorëve të ndryshëm elitar nga mbarë bota islame, vizitat në institucionet e ndryshme të vendit, takimet ndërfaqetare, kurset e fëmijëve, aktivitetet e larmishme për fëmijët e kurseve fetare, takimet periodike me imamët, inspektimi i vakëfeve, ndërtimi i xhamive dhe restaurimi i tyre, përkujdesja për ambientet e qendrave kulturore, emisionet televizive dhe ato radiofonike, botimet e librave të rinj, dalja sistematike e gazetës “Udha Islame”, trajnimi i haxhilerëve, organizimi i përcjelljes dhe pritjes së tyre, por jo vetëm, ishin pjesë

e raportit të përgjithshëm për vitin 2024 të aktivitetit të Myftinisë Shkodër.

Gjatë raportimit të secilit prej drejtuesve të sektorëve përkatës iu dha mundësia edhe të pranishmëve, që të bënin ndërhyrjet e tyre, pyetje, përgjigje dhe sqarime për çdo detaj prej këtij raporti.

Në fund të këtij takimi pune, Myftiu falënderoi të gjithë për angazhimin dhe dha sugjerimet dhe këshillat e tij për detaje të caktuara të raportit të vitit 2024 dhe porositi e tij për periudhën deri në fund të vitit 2025, që pritet të jetë një vit i mbushur me aktivitetet dhe zhvillime të reja pozitive për Myftininë e Shkodrës dhe besimtarët e saj.

MYFTIU I SHKODRËS PRITI DREJTORIN E FONDACIONIT “MIRËSIA”

Ditën e mërkurë, më 22 janar 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim pune drejtorin e Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja.

Gjatë takimit të përzemërt Myftiu falënderoi bashkëpunimin e gjatë, që Myftinia Shkodër ka me Fondacionin “Mirësia”, ku theksoi se falë këtij bashkëpunimi është realizuar ndërtimi i disa xhamive dhe qendrave kulturore, që i shërbejnë më së miri gjallërimit të aktivitetit fetar dhe kulturor islam në qytetin e Shkodrës.

Myftiu tha se, ndërtimi i shumë xhamive në fshatra të zonave të ndryshme dhe i qendrave kulturore është një shtysë më shumë për besimtarët, dhe rininë në veçanti, që të jenë frekuentues të rregullt të xhamive dhe ndjekës të etur të aktiviteteve të ndryshme, që zhvillohen në këto qendra kulturore.

Nga ana e tij, drejtori i Fondacionit



“Mirësia” z. Kaja, falënderoi Myftiun Sytari për gatishmërinë e tij të përhershme për të gjetur urat e komunikimit dhe për të shtuar bashkëpunimin me Fondacionin “Mirësia”, dhe theksoi se projektet e shumta, që ky Fondacion ka në Shkodër dhe në qytete të ndryshme të Shqipërisë, projekte që mbështeten nga Shteti i Kuvajtit, por edhe nga vende të tjera të Gadishullit Arabik, por jo vetëm, janë

dëshmi e përpjekjeve të vazhdueshme për t’i shërbyer Thirrjes Islame dhe besimtarëve kudo që janë.

Në këtë takim u diskutua edhe për inaugurimin e afërt të një prej Qendrave Kulturore në qytetin e Shkodrës, si dhe u diskutua për fillimin e punimeve për ndërtimin e dy objekteve të reja që i shërbejnë interesave të Myftinisë së Shkodrës.

MYFTIU PRITI NË NJË TAKIM LAMTUMIRE MONS. ANGELO MASSAFRA PËRPARA LARGIMIT TË TIJ NGA SHQIPËRIA

Paraditën e së martës, më 21 janar 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim të veçantë lamtumire, Mons. Angelo Masafra, Arqipeshkv në Dioqezën Shkodër-Pult për më shumë se dy dekada.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu Sytari dhe Arqipeshkvi Masafra ndanë mendime dhe kujtime nga bashkëpunimi i gjerë ndër vite, ku u përmenden aktivitetet e larmishme, vizitat, takimet dhe përpjekjet pozitive për të ruajtur dhe ndërtuar bashkërisht ura të reja të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfaqetare në qytetin e Shkodrës.

Gjatë këtij takimi, ku të pranishëm ishin edhe Arqipeshkvi i ri, Mons. Giovanni Peragine, dom Nikolin Toma, H. Arben Halluni dhe H. Lavdrim Hamja, autoritetet fetare ndanë mendime dhe ide mbi rëndësinë e bashkëjetesës ndërfaqetare dhe domosdoshmërinë e promovimit në vazhdim të vlerave të paqes sociale dhe harmonisë në Shkodër, por jo vetëm.

Myftiu dhe Arqipeshkvi ishin të mendimit se, përtej faktit se shpesh thirrjet e tyre bien në vesh të shurdhër, e rëndësishme është vazhdimësia në



përcjelljen e mesazheve dhe nxitja e përhershme e besimtarëve, dhe e rinisë në veçanti, për t’u kthyer nga Zoti dhe për t’u kapur pas vlerave dhe udhëzimit fetar.

Mons. Masafra vlerësoi kontributin e Myftiut Sytari në forcimin e dialogut ndërfaqetar, duke theksuar se roli i tij ka qenë i pazëvendësueshëm në ndërtimin e urave të bashkimit mes komuniteteve fetare.

Nga ana tjetër, Myftiu Sytari shprehu mirënjohjen e tij për bashkëpunimet e shpeshta me Arqipeshkvinë e Shkodrës

gjatë viteve të drejtimit të saj nga Mons. Masafra, duke veçuar rëndësinë e bashkëpunimit përmes aktiviteteve dhe takimeve të larmishme në përballje me sfidat e përbashkëta dhe përpjekjet për shërimin e krizave dhe problemeve sociale dhe shpirtërore.

Në fund të këtij takimi, Myftiu, Imam Muhamed B. Sytari i dhuroi Arqipeshkut, Mons. Masafra një dhuratë simbolike si një shenjë kujtimi i bashkëpunimit dhe frymës së harmonisë së dëshmuar ndër vite në mesin e komuniteteve fetare në Shkodër.

MYFTIU SYTARI PRITI NË NJË TAKIM PUNE KRYETARIN E BASHKISË SHKODËR, Z. BENET BECI

Paraditen e së mërkurës, më 22 janar 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim pune kryetarin e Bashkisë Shkodër, z. Benet Beci.

Gjatë këtij takimi u diskutua në detaje edhe për projektin e rehabilitimit të zonës së Zdrales dhe në veçanti pjesës së xhamisë së Parrucës. Myftiu Sytari dhe Kryetari i Bashkisë Beci panë dhe inspektuan në terren edhe zonën ku pritet të bëhen ndërhyrjet për të cilat u diskutua me detaje.

Myftiu theksoi se, viti 2025 është edhe viti i 35 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, me ç’rast theksoi se ky vit jubilar do të shënojë një sërë aktivitetesh, ku në qendër të tyre është edhe inaugurimi i xhamisë së Plumbit, tashmë e rehabilituar, e rikonstruktuar dhe e mbrojtur nga përmytjet, falë investimit madhor të qeverisë turke dhe premtimit të mbajtur të Presidentit të Turqisë, Z. Rexhep Tajib Erdogan.



Ai theksoi njëkohësisht se, shtëpia e familjes Myftija, një shtëpi e vjetër muslimane shkodrane, duhet të jetë pjesë e kompleksit të restaurimeve që po zhvillohen në atë zonë. Myftiu tha se, i mjafton nder Myftinisë së Shkodrës, por edhe mbarë qytetit, që shtëpia e Myftiejve është vendi ku ka jetuar personaliteti i shquar dhe dijetari i

madh islam shqiptar, Jusuf ef. Tabaku. Poashtu në atë shtëpi ka jetuar edhe Hfz. Esat Myftia, kryetari i fundit i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, para periudhës së errët komuniste.

Bashkëbisedimi i Myftiut dhe i Kryetari të Bashkisë u ndal edhe te disa çështje të tjera me rëndësi dhe interes të përbashkët për të dy institucionet.

RADIO "FATIH" NË MAL TË ZI, BASHKËBISEDIM ME MYFTIUN E SHKODRËS

Paraditen e së mërkurës, më 22 janar 2025, Myftiu i Shkodrës priti në zyrën e tij përgjegjësin e Radio "Fatih" në Podgoricë të Malit të Zi, Enis ef. Hoxha. Shkak i kësaj vizite ishte dëshira e shfaqur nga Radio "Fatih" për të zhvilluar një bashkëbisedim me Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari me rastin e muajit të madhërueshëm të Ramazanit.

Në përgjigje të pyetjeve të z. Hoxha, Myftiu Sytari vuri theksin te rëndësia e madhe që muaji i madhërueshëm i Ramazanit, të cilin e krahasoi me stinën e pranverës, që të gjithë e presim me padurim; stinë në të cilën ripërtërihet jeta, gjallërohet natyra dhe të gjithë gëzohemi me mirësitë dhe fladët bekuese të saj.

Myftiu tha se, muaji i madhërueshëm i Ramazanit është mundësia më e mirë që besimtarët të rigjejnë ekuilibrat e vetvetes dhe të përsosin marrëdhënien e tyre me Zotin e gjithësisë duke u kujdesur për përsosmërinë e namazit, e agjërit, leximit të Kur'anit, sadakasë dhe veprave të mira pa përjashtim.

Myftiu Sytari vuri theksin gjithashtu te domosdoshmëria e ruajtjes së ekuilibrit të muslimanit me Kur'anin



Famëlartë, si libri i vetëm, garancia e të cilit nuk ka afat skadence. Ai tha se, Zoti i gjithësisë e ka garantuar këtë libër deri në ditën e fundit, që do të thotë se njerëzimi e ka përherë një zgjidhje dhe një alternativë të shëndoshë për të korrigjuar veten dhe për të gjetur shërim për lëngatat dhe sëmundjet e ndryshme me të cilat përballlet në jetën e tij. Ai tha se, njeriu i sotëm më shumë se kurrë ka nevojë të kthehet nga Kur'ani dhe të marrë dritën e udhëzimit të Zotit të gjithësisë nëpërmjet sureve dhe ajeteve të shumta të tij.

Myftiu i Shkodrës bëri një krahasim, ku tha se, vitin e kaluar dëgjuam për

djegien e Kur'anit në një prej vendeve të qytetëruara të Evropës. Ai tha se, muslimani që e lexon Kur'anin sot, por nuk i nënshtrohet porosive dhe urdhëresave hyjnore dhe që thyen urdhëresat e Zotit, që neglizhon porosinë e Tij, që nuk merr në konsideratë fjalën e Zotit dhe vepron të kundërtën e saj, në fakt po bën një veprim më të rëndë se sa djegien fizike të librit të Zotit.

Myftiu i Shkodrës uroi të gjithë besimtarët muslimanë në Mal të Zi, në Ballkan dhe në mbarë botën për një Ramazan të mbarë dhe të mbushur me bekime dhe mirësi.

"UDHËTIMI QË NDRYSHOI BOTËN", BASHKËBISEDIM ME RASTIN E NATËS SË ISRASË DHE MIRAXHIT

Ditën e mërkurë, më 22 janar 2025, pas namazit të iqindisë, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë e Parrucës një aktivitet fetaro-kulturor për motrat muslimane, me rastin e Natës së Bekuar të Israsë dhe Miraxhit.

Aktiviteti i titulluar "Udhëtimi që ndryshoi botën", u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi me pjesëmarrjen e teologeve dhe vaizeve të nderuara të Myftinisë Shkodër: Znj. Ferzet Ndoja, Znj. Zamira Bushati-Puka dhe Znj. Jetmira Plaku. Gjatë këtij bashkëbisedimi, teologët ndanë njohuritë dhe mesazhet e tyre mbi këtë ngjarje madhështore dhe iu përgjigjën pyetjeve të pjesëmarrëseve.

Diskutimet u përqendruan në Isranë dhe Miraxhin, një prej ngjarjeve më të rëndësishme të jetës së Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

Ky udhëtim hyjnor u trajtua në detaje, duke theksuar domethënien



dhe rëndësinë e tij, ngjarjet kryesore të Miraxhit në shtresat qiellore, si dhe bashkëbisedimin e Profetit me Allahun e Lartësuar në Sidretul-Munteha. Po ashtu, u analizuan mësimet dhe mesazhet e kësaj ngjarjeje të bekuar, me fokus të veçantë në rëndësinë e namazit dhe ndjekjen e udhëzimeve hyjnore si një model për rritjen shpirtërore në jetën e përditshme.



Aktiviteti u përmbyll me një reflektim të përbashkët mbi domethënien e kësaj nate për besimtarët dhe fuqinë e saj për të përfortuar lidhjen me Zotin. Në fund u bë dhe një dua e përzemërt dhe falënderime të sinqerta për grupin organizativ, si dhe për të gjitha pjesëmarrëset, të cilat e pasuruan këtë aktivitet me praninë e tyre.

"TRE MUAJT E MIRË DHE THIRRJA E BESIMIT", NË XHAMINË E VUKATANËS

Ditën e enjte, më 23 janar 2025, në vazhden e ciklit të ligjëratave "Tre Muajt e Mirë dhe thirrja e besimit", Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Shkodrës ligjëroi në xhaminë e fshatit Vukatanë.

Pas faljes së namazit të akshamit, që u drejtua nga imami i xhamisë së Barbullushit, H. Ervis Molla, fjalën e hapjes e mbajti i imami i xhamisë Vukatanë, H. Vullnet Pishitari, i cili pasi i uroi mirëseardhjen Myftiut të Shkodrës, imamëve të pranishëm dhe xhematit të shumtë në numër, theksoi se tubime të tilla e gjallërojnë jetën fetare në xhamitë tona.

Më pas fjalën e mori Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili shprehu emocionet dhe kënaqësinë e tij për praninë në fshatin Vukatanë, ku theksoi se kjo tokë është vendi i paraardhësve të dijetarit të madh e të shquar islam me famë botërore, hoxhës tonë, Shejkh Shuajb Arnauti.

Myftiu gjithashtu u lut për shpirtat e hoxhallarëve të shumtë, që përgjatë shekujve kanë dhënë kontributin e tyre të vyer në shërbim të besimtarëve dhe komunitetit në Vukatanë, por jo vetëm.

Më pas, në ligjëratën e tij, Myftiu i Shkodrës u ndal te tefsiri i ajetit 25 i



sures Junus, ku hodhi dritë rreth detajeve të këtij ajeti në të cilin Zoti i gjithësisë, Allahu (a.xh) urdhëron e thotë: "Allahu ju fton drejt Darus-Selam dhe udhëzon kë të dojë drejt rrugës së Tij të drejtë!"

Nëpërmjet shembujve të ndryshëm, krahasimeve dhe pyetjeve drejtuar të pranishmëve, Myftiu hodhi dritë rreth thelbit të këtij ajeti kur'anor, ku vuri theksin te domosdoshmëria e angazhimit të besimtarëve me thirrjen e Allahut (a.xh) në Kur'anin Famëlartë dhe mësimet e shumta nëpërmjet të cilave njeriu udhëzohet për të qenë mëkëmbës

i Zotit në tokë.

Myftiu theksoi se, ai njeri i cili sakrifikon xhenetin dhe shpërblimet e panumërta në jetën e përditshme për interesat e ngushta dhe kalimtare të kësaj bote të përkohshme dëshmon se nuk e ka kuptuar qëllimin e jetës, as ka punuar për të ardhmen e tij.

Në fund të kësaj mbrëmje të begatë për të pranishmit ishte përgatitur një koktejl, që u shoqërua edhe me pyetje-përgjigje, urime dhe me bashkëbisedime të ngrohta në mesin e vëllezërve.

MYFTIU I SHKODRËS: "NATA E ISRASË DHE MIRAXHIT, FTESË PËR T'U LIDHUR ME MREKULLITË E ZOTIT NË JETË!"

Ditën e xhuma, më 24 janar 2025, nga xhamia e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në hytben e kësaj xhumaje ka dhënë mesazhe me vlerë për një ngjarje të madhe historike islame, atë të Natës së Madhe të Israsë dhe Miraxhit.

Gjatë hytbes së kësaj xhumaje, Myftiu vuri theksin te rëndësia e madhe që kanë mrekullitë në jetën e Pejgamberëve nëpërmjet të cilave Zoti i gjithësisë i dëshmon të Dërguarve të Tij, besimtarëve dhe mbarë njerëzimit, përkrahjen dhe mëshirën e Tij të përhershme ndaj tyre. Në këtë kontekst, Myftiu theksoi se Nata e Israsë dhe Miraxhit është kurora e mrekullive me të cilat u dërgua Hz. Muhammedi (a.s.).

Njëkohësisht ai tha se, thelbi i Natës së Israsë dhe Miraxhit është obligimi i faljes së pesë namazeve ditore për çdo besimtar musliman deri në ditën



e fundit. Nga këtu, ai theksoi se është momenti që të tërheqim vëmendjen drejt respektimit dhe shfrytëzimit të këtij adhurimi të mrekullueshëm ditor për t'u rritur në marrëdhënien tonë me Allahun e Madhëruar dhe për ta konsideruar çdo namaz ditor si një mundësi miraxhi

drejt Zotit të gjithësisë për t'u lartësuar në besimin tonë, në moralin tonë, në mirësjelljen tonë, në komunikimin tonë të përditshëm me njerëzit dhe për të gjetur qetësinë pas çdo sprove a përballje, që kemi në jetën tonë të përditshme.

MBAHET KONFERENCA E 13-TË VJETORE E IMAMËVE TË SHKODRËS: “ISLAMI, FÉ UNIVERSALE, NË SHËRBIM TË NJERIUT!”

Paraditën e së shtunës, më 25 janar 2025, në xhaminë e Parrucës u zhvillua konferenca e 13-të vjetore e imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, me temë: “Islami, fé universale, në shërbim të njeriut!”

Kumtesat e përgatitura nga imamët dhe teologët ishin të larmishme dhe interesante, me tefsire të ajeteve kur'anore, komentime të haditheve profetike dhe tema të tjera fetaro-shkencore, rreth universalizmit të fesë islame në çdo fushë të jetës njerëzore, një fé për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh racën, kombësinë dhe kulturën, rreth marrëdhënieve ndër njerëzore, por jo vetëm. etj.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në fjalën dhe kumtesën e tij me temë: “Toleranca ndërfaqetare, vlerë historike dhe sociale te muslimanët”,



prej çështjeve të rëndësishme që ka njohur historia njerëzore: “Bashkëjetesa ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve, gjatë 14 shekujve të kaluar e deri më sot, është një prej çështjeve me një rëndësi të veçantë në historinë e qytetërimeve, që ka njohur përshkallëzime dypolare dhe ka arritur

diturinë!”

Anis Agovi – Haku i komshiut të tekstet islame

Ardit Ulqinaku – Pozita e jetimit të Islam

Besim Barbullushi – Roli i babait në formimin dhe edukimin e fëmijëve



në mes të tjerave ka nënvizuar: “Kushdo që e shfleton Kur'anin Famëllartë dhe mediton në emërtimet e sureve, si dhe në përmbajtjen e shumë ajeteve, ku përmenden të dërguarit e mëparshëm, me emra dhe detaje, pasuesit e Librave të Shenjtë, me emra dhe detaje, si dhe ku jepen udhëzime drejt ruajtjes së ekuilibrave në shoqëri, bazuar në besimin në Një Zot dhe shfaqjen e drejtësisë, kupton qartë se, Zoti i gjithësisë, ka kërkuar nga njeriu që të jetojë në harmoni me tjetrin, kushdo qoftë ai”.

Më tej Myftiu nënvizoi se bashkëjetesa ndërfaqetare është

kulme interesante, që ia vlen përherë të studiohen e të merren si shembuj për të sotmen!”

Myftiu u ndal konkretisht me shembuj konkret të bashkëjetesës fetare në Shqipëri që është një nga vlerat më unike dhe të veçanta të kombit shqiptar, që shpesh përmendet si një shembull frymëzues për harmoninë ndërfaqetare në botë.

Në këtë konferencë referuan:

Arben Halluni – Islami, besim dhe veprim

Adem Pizga – Tefsiri i ajetit 114 të sures Ta Ha: “O Zot im, ma shto

Durim Kasemi – Mëshira për kafshët, si dëshmi e misionit universal në Islam

Idmir Plaku – Tefsiri i ajetit 180 të sures El-Araf: “Allahut i takojnë emrat më të bukur!”

Lavdrim Hamja – Fenomenet natyrore në Kur'an dhe Hadith

Naim Drijaj – Llojet e nefsit në Kur'anin Famëllartë

Samel Haxhija – Tefsiri i ajetit 41 të sures Err-Rrum: “Është shfaqur shkatërrimi në tokë dhe në det..!”

Në fund, u zhvilluan diskutime, konkluzione dhe përfundime të konferencës.

LIGJËRATË FETARE PËR MOTRAT NË XHAMINË E FSHATIT BARBULLUSH

Paraditen e së dielës, më 26 janar 2025, në atmosferën e begatë të përkujtimit të mrekullive të Natës së Israsë dhe Miraxhit, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare për motrat besimtare në xhaminë e fshatit Barbullush.

Ligjëruese në këtë aktivitet ishte vajza Ferzet Ndoja, e cila u përqendrua te mesazhet e shumta që ka Nata e Israsë dhe Miraxhit.

Në krye të herë ajo theksoi se, në kalendarin islam ka data të shumta, të cilat na tërheqin drejt besimit dhe forcimit të marrëdhënies me Zotin e gjithësisë.



Ajo u ndal te disa detaje të ngjarjes së mrekullueshme të Israsë dhe Miraxhit duke i lidhur ato me rëndësinë, që ka angazhimi i gruas muslimane në jetën e

përditshme për t'u përballur me kurajo dhe besim me vështirësitë dhe sprovat e shumta me të cilat përballet në jetën e përditshme. Ajo vuri theksin te rëndësia që ka përkujdesja për familjen dhe angazhimi me edukimin e fëmijëve për t'u rritur me besim të pastër me moral të lartë dhe angazhim të vazhdueshëm për lartësim në gradat e dijes dhe zhvillimit.

Aktiviteti iu gërshetua edhe me pyetje-përgjigje, bashkëbisedime të ndryshme, si dhe u shfaq dëshira e vazhimit të këtyre ligjëratave në mënyrë sistematike, ashtu që tema të ndryshme që i interesojnë komunitetit dhe motrave në veçanti, të trajtohen herë pas herë në xhaminë e fshatit Barbullush.



NË XHAMINË E URËS SË BUNËS U PËRKUJTUA NATA E ISRASË DHE MIRAXHIT

Paraditen e së dielës, më 26 janar 2025, Myftinia Shkodër zhvilloi një tribunë fetare për motrat besimtare, që frekuentojnë xhaminë e Urës së Bunës.

Ligjëruese në këtë aktivitet ishte vajza Jetmira Plaku, e cila u ndal te vlera e madhe e përkujtimit të mrekullive të Natës së Israsë dhe Miraxhit, si një moment kulminant në jetën e të Dërguarit të Allahut, Hz. Muhamedit (a.s).

Ajo theksoi se, akoma sot kur lexojmë dhe shfetojmë rreth mrekullive të Natës së Israsë dhe Miraxhit kuptojmë për mëshirën e madhe dhe dashurinë e Allahut për të



Dërguarin e Tij dhe garancinë, që Zoti i gjithësisë i ka dhënë kësaj feje të madhnueshme islame. Ajo theksoi se, në jetën tonë të përditshme ka vështirësi dhe sprova të shumta me të cilat ne përballemi, dhe shpeshherë njeriu duket se nuk ka asnjë shpresë përballë tyre; mirëpo po të shohim me vëmendje në jetën tonë na është dhënë mrekullia më e madhe, me të cilën afrohem me Zotin tonë, përballemi me vështirësitë e jetës dhe lartësohemi drejt dashnisë së Zotit, dhe jo mrekulli është namazi.

Namazi ishte dhuntia kryesore e Natës së Israsë dhe Miraxhit, që u obligua për të Dërguarin e Allahut dhe besimtarët deri në ditën e fundit.

Vajza e nderuar vuri theksin te rëndësia që ka përsosja e namazit në jetën e përditshme dhe përpjekja për ta realizuar atë të plotë, si një garanci dhe siguri nga Zoti i gjithësisë për besimtarin në jetën e përditshme.

Aktiviteti u shoqërua me pyetje të ndryshme dhe një koktejl të organizuar me këtë rast.



MYFTINIA SHKODËR

“
Njeriu
ME MORALIN E MIRË
arrin gradën e atij,
që falet natën
dhe agjëron ditën!
”

(Transmetuar nga Ebu Davudi)



MyftiniaShkoder1990



www.myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org